

Raport (draft)

Autonomia dhe Menaxhimi Financiar i Universiteteve Publike në Shqipëri

1 Shtator 2017 - 13 Qershor 2018



PËRMBAJTJA

- 1. Hyrje**
- 2. Gjetjet kryesore**
- 3. Analiza e transaksioneve**
 - 3.1 Kategoria “Shpenzime Personeli”**
 - 3.2 Kategoria “Investime”**
 - 3.3 Kategoria “Blerje mallrash”**
 - 3.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”**
 - 3.5 Kategoritë “Transferta dhe Subvencione” dhe “Të tjera”**
- 4. Autonomia financiare e universiteteve publike**
- 5. Transparenca e IAL-ve**
- 6. Rekomandime**
- 7. Shtojca**

1. Hyrje

Qëndresa Qytetare është një organizatë e fokusuar tek fuqizimi i rolit të qytetarit në shoqëri dhe synon përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet angazhimit dhe aktivizmit qytetar. Nisur nga mungesa e shërbimeve ndaj studentëve në universitetet publike, ankesat e shumta prej tyre dhe tarifat e larta nga ana tjetër, vendosëm të kryejmë këtë monitorim me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert. Një tjetër arsye që na shtyu të vëzhgojmë mënyrën e menaxhimit të këtyre universiteteve ishin edhe raportet e dobëta nga komisioni i akreditimit si edhe raporti i Institutit të Statistikave të UNESCO-s, ku Shqipëria renditet e para në Europë për numër më të lartë të studentëve që zgjedhin për të studiuar jashtë për 1000 banorë.¹

Në kuadër të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ndryshimeve që institucionet e arsimit të lartë pësuan sa i takon menaxhimit financiar dhe administrimit, Qëndresa Qytetare monitoroi tre universitete publike me fokus investimet dhe nivelin e transparencës së tyre në raport me publikun dhe studentët për periudhën 1 Shtator 2017 deri më 13 Qershor 2018. Universitetet e përzgjedhura për këtë monitorim ishin: Universiteti i Tiranës, Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu” dhe Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Ky monitorim shërben për të hedhur dritë mbi mënyrën se si janë shpenzuar të ardhurat që grumbullohen nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat që vijnë nga buxheti i shtetit duke u munduar për ti dhënë një përgjigje pyetjes se a reflektohen nevojat reale të studentëve apo kemi të bëjmë më një administrim jo efektiv të buxhetit vjetor?

¹ <http://www.monitor.al/shqiperia-numrin-te-larte-te-studenteve-ne-europe-qe-studiojne-jashte/>

Metodologjia e Përdorur

Grupi i monitoruesve shfrytëzoi dhe gërshetoi një sërë burimesh të informacionit për të mos krijuar konfuzion ose paqartësi në paraqitjen e të dhënave.

Monitorimi u bazua në analizën ligjore të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë sa i përket organeve të administrimit financiar në universitete dhe shqyrtimit të të dhënave të përfituara nga transaksionet e thesarit. Njëkohësisht, plot 30 kërkesa për informacion drejtuar universiteteve të përzgjedhura u dërguan nga grupi i punës i përbërë nga anëtarët e Task Forcës Studentore në lidhje me buxhetin, investimet dhe destinacionin e parave të mbledhura nga tarifat e studentëve.

Pjesë e këtij procesi ishte edhe një metodologji specifike e hartuar për të matur nivelin e transparencës së paraqitur në faqet zyrtare të universiteteve dhe stendat fizike të vendosura në ambientet e tyre dhe respektimin e ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

2. Gjetjet Kryesore

- Universiteti i Elbasanit gjatë gjithë vitit akademik 2017 - 2018 i ka kaluar të gjitha pagesat e Pagës Bazë në emër të **F.Q**, me detyrë drejtor i zyrës ekonomike të universitetit. Ndërkohë, është po Universiteti i Elbasanit që ka kryer pagesat më të larta për Bordin Administrativ me plot 9,392,821, ndërsa ai i Durrësit ka bërë pagesat me vlerë 5,574,640 lekë për këtë organ administrativ.
- Nga monitorimi i transaksioneve rezulton se tre universitetet publike janë më larg shkencës dhe më pranë luksit të zyrave, pasi nuk kanë shpenzuar **asnjë vlerë për nënkategorinë studime dhe kërkime** përgjatë 1 viti akademik. Nga ana tjetër vëmë re se paratë e tarifave të studentëve dhe të ardhurat nga buxheti i shtetit janë shpenzuar përkatësisht për investime luksi dhe zyrash. Mbi 1 miliardë lekë të vjetra ka shpenzuar Universiteti i Durrësit për rikonstruksione ndërtesash dhe pajisje zyrash, ndërsa Universiteti i Elbasanit ka blerë një automjet pranë kompanisë Hyundai në vlerën 76 milion lekë të vjetra.
- Referuar pagesave të faturave për **energji elektrike**, Universitetit i Tiranës, megjithëse ka në menaxhim më shumë godina funksionale se dy

universitetet e tjera, ka shpenzuar 7 herë më pak se ai i Elbasanit dhe 14 herë më pak se universiteti i Durrësit i cili ka shpenzuar ekzaktësisht 14,341,150 lekë për këtë nënkategori. Për nënkategorinë **Ujë**, konsumatori më i madh është Universiteti i Elbasanit duke kryer transaksione me vlerë shumë më të madhe se dy universitetet e tjera, 5,456,404 lekë, kundrejt shumës 311,000 lekë të Universitetit të Tiranës dhe 497,052 lekë të Universitetit të Durrësit.

- Universiteti “Aleksandër Xhuvani” ka kryer një transfertë me vlerë 319,440 lekë kundrejt përfituesit “Alban Tirana NASCENDO AL” me përshkrim fature “1011099 Universiteti Aleksandër Xhuvani **abonim karte TV** urdhër nr 304 dt 22.12.2017 ft nr 393544435” në kategorinë shërbime të printimit dhe publikimit. Së pari, studentët duhet të informohen se paratë e tyre po shkojnë për një shpenzim luksi për zyrat e drejtuesve sic është abonimi tv, ndërkohë që ambientet universitare nuk kanë internet falas, së dyti kjo vlerë nuk përkon me vlerat reale të tregut të operatorëve dixhitalë dhe së treti, ky transaksion është kategorizuar në një kategori jopërfshirëse sic është ajo e publikimeve.
- Nga monitorimi janë evidentuar pagesa të larta që universitetet shpenzojnë për sigurimin e ndërtesave. Universiteti i Tiranës ka shpenzuar vlerën 21,304,490 lekë, Universiteti i Durrësit 10,780,030 lekë dhe Universiteti i Elbasanit 28,001,291 lekë për nënkategorinë **“Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave”**, shërbim i cili nuk justifikon mjaftueshëm shërbimin e sigurimit për ndërtesën apo për pajisjet që ato kanë, pasi zënë një shumë të konsiderueshme që buron nga tarifatat e studentëve apo nga buxheti i shtetit dhe në përshkrimin e faturave shoqërohet me fjalët shërbim roje. Ndërkohë që universitetet paguajnë kaq shtrenjtë shërbimin e rojes, studentët vuajnë pasojat e mungesës së shërbimeve minimale si kartonat e diplomave, internetit, ngrohjes dhe ftohjes apo për të mos thënë laboratorëve dhe bibliotekave.
- Në kategorinë “Të Tjera” ku janë përfshirë shpenzimet për Bursa Studimi si dhe Shpenzimet Gjyqësore, vëmë re se Universiteti i Tiranës nuk ka kryer asnjë transaksion për nënkategorinë **Bursa Studimi** për këtë vit akademik dhe ka shpenzuar plot 45,577,368 lekë që lidhen kryesisht me vendimet gjyqësore **për largimet e padrejta nga puna**. Ky është rasti kur keq-administrimi dhe papërgjegjshmëria e titullarëve rëndon mbi xhepat e studentëve pasi universiteti detyrohet të paguajë paratë e studentëve për punonjësit e larguar në mënyrë të padrejtë nga puna, duke lënë vetë studentët ekselentë pa bursa.

- Nga monitorimi ynë dhe pasqyra e transaksioneve financiare rezulton se UT, ku shumicën në **Bordin e Administrimit** e ka vetë universiteti, nuk ka arritur të shpenzojë dot paratë për shkak të ngërçeve dhe mosmarrëveshjeve midis vetë anëtarëve të Bordit dhe Senatit, ndërsa dy universitetet, shumicën e bordeve të të cilave e zotëron MASR, i kanë shpenzuar paratë, por jo në funksion të kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve, por për kolltuqe, makina dhe klientë të kompanive të sigurimit. Në të tri Bordet e Administrimit anëtarët e caktuar nga MASR janë punonjës dhe drejtues të lartë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Bordi i Administrimit të Universitetit të Elbasanit është mbledhur vetëm 7 herë gjatë vitit 2018. Anëtarët e këtij bordi nëpërmjet vendimit nr.13, datë 10/07/2017 i kanë caktuar vetes një shpërblym mujor prej **35.000 lekë/muaj**, duke i shtuar pagave të tyre prej burokrati edhe një shumë të konsiderueshme mujore.
- Nga 30 kërkesat e dërguara, vetëm për dy prej tyre morëm përgjigje në afat nga Universiteti i Tiranës por ky universitet para se të përgjigjej dërgoi një faturë në vlerën **1000 lekë të reja për ta paguar në këmbim të këtij shërbimi**, me arsyetimin se neni 13 i ligjit për të drejtën e informimit i lejon të vendosë një tarifë të tillë në këmbim të informacionit. Pas ankimit nga Qëndresa Qytetare të kësaj tarife si të anti-ligjshme pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ky i fundit doli me një vendim për të urdhëruar senatin akademik të UT për të shfuqizuar tarifën e të drejtës së informimit.

3. Analiza e transaksioneve të universiteteve publike

Monitoruesit dhe ekspertët e Qëndresës Qytetare kanë kaluar në sitë dhe kanë përpunuar në mënyrë të thjeshtëzuar të gjitha transaksionet që kanë kryer tre universitetet publike duke përfshirë të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Njëpërmjet kalimeve të vlerave tek të tretët apo personeli duke marrë në konsideratë edhe përshkrimin e çdo transaksioni, është bërë i mundur edhe evidentimi i pagesave dhe transfertave të dyshimta apo të pa justifikuara.

Gjatë periudhës së marrë në analizë, universitetet e përzgjedhura kanë kryer përkatësisht në total transaksione me këto vlera:

Universiteti i Tiranës: 131,310,871 lekë

Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu" : 384,891,203 lekë

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" : 262,964,568 lekë

Transaksione të Thesarit 1 Shtator 2017 – 13 Qershor 2018				
	Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
II	Shpenzime personeli	48,607,808	336,293,751	257,745,722
III	Investime	1,610,490	114,412,773	15,736,440
IV	Blerje mallrash	10,185,117	38,821,739	31,097,778
V	Sigurimi i shërbimeve	22,593,275	48,384,739	47,132,940
VI	Transferta dhe Subvencione	2,736,813	130,826	184,691
VII	Të tjera	45,577,368	31,893,022	41,982,335
	Totali	131,310,871	569,936,850	393,879,906

Ajo që bie në sy fillimisht është fakti se shpenzimet e Universitetit të Tiranës, i cili është dhe Universiteti më i madh publik në Shqipëri janë shumë herë më pak se ato të Universitetit të Durrësit apo atij të Elbasanit.

Përkatësisht rreth 4.5 herë më pak se Universiteti i Durrësit dhe rreth 3 herë më pak se Universiteti i Elbasanit. Kjo situatë ka ardhur edhe si pasojë e ngërçit të krijuar ndërmjet Rektorit dhe Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës, situatë e cila u shoqërua edhe me protesta për pagat e pedagogëve. Grupi i monitoruesve ka identifikuar një sërë transaksionesh të ndara sipas kategorive të cilat nuk përputhen as me vlerat normale të pagesave, as me nevojat që mund të ketë një universitet publik, parë në raport me buxhetin e tij total.

Konkretisht sipas kategorive të shpenzimeve universitetet kanë bërë këto shpenzime :

3.1 Kategoria “Shpenzime Personeli”

Në nën kategorinë “Paga Bazë” universitetet kanë shpenzuar përkatësisht : 48,607,808 lekë Universiteti i Tiranës, 336,293,751 lekë Universiteti i Durrësit dhe 257,745,722 lekë Universiteti i Elbasanit. Ajo që vëmë re në shpenzimet brenda kësaj kategorie është se Universiteti i Elbasanit ndryshe nga dy Universitetet e tjera nuk ka bërë asnjë pagesë për nënkategorinë “paga me kontratë për kohë të kufizuar”, pra pedagogët e jashtëm nuk janë paguar ende, ndërsa Universiteti i Tiranës nuk ka bërë asnjë pagesë për anëtarët e Bordit Administrativ. Ndërkohë që është Universiteti i Elbasanit ai që ka kryer pagesat më të larta për Bordin Administrativ me plot 9,392,821 ndërsa ai i Elbasanit pagesat me vlerën 5,574,640 lekë për këtë organ administrativ.

Universiteti i Elbasanit gjatë gjithë vitit akademik 2017 - 2018 i ka kaluar të gjitha pagesat e Pagës Bazë në emër të **F.Q.**, me detyrë drejtor i zyrës ekonomike të universitetit. Për periudhën Shtator 2017 - Mars 2018, Universiteti i Elbasanit ka kryer 7 transaksione me vlerë 153,219,701 lekë për z. Filip Qosja, ndërsa për periudhën Mars – Qershor 2018 janë kryer 4 transaksione kundrejt tij me vlerën 68,681,071 lekë, shumë që përkon me vlerën e plotë të kësaj nënkategorie për këtë univeristet.

Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Shpenzime personeli	48,607,808.00	336,293,751.00	257,745,722.00
Paga	29,798,222.00	293,151,821.00	243,818,941.00
Honorare + Të tjera shpërblime për personelin	16,731,529.00	17,966,673.00	31,642.00
Paga me kontratë për kohë të kufizuar	1,327,695.00	18,300,447.00	0.00
Dieta-Udhëtime	750,362.00	1,300,170.00	4,502,318.00
Pagesa anëtarët e bordit administrativ	0.00	5,574,640.00	9,392,821.00

3.2 Kategoria “Investime”

Për kategorinë investime, ajo që bie në sy për Universitetin e Durrësit janë pagesa të ndryshme me vlerë totale 99,410,043 lekë të bëra ndaj Kevin Construction për nënkategorinë rikonstruksion ndërtese dhe plot 15,000,000 lekë të shpenzuara për pajisje dhe orendi zyre. Universiteti i Elbasanit ka kryer për këtë kategori shpenzimet me vlerën 7,712,640 lekë, pagesa këto të kryera nën kategorinë **Mjete transporti** me vlerën 7,620,000 lekë kundrejt kompanisë “HYUNDAI AUTO ALBANIA” me përshkrimin: “Universiteti Aleksandër Xhuvani blerje automjeti.”

Ajo që bie në sy nga të tre universitetet është fakti se janë më larg shkencës dhe më pranë luksit të zyrave, pasi në një vit akademik nuk kanë shpenzuar asnjë vlerë për nënkategorinë studime dhe kërkime, që do të thotë se paratë e tarifave të studentëve janë përkthyer në pajisje zyrash, makina luksi dhe ndërtime godinash.

Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Investime	1,610,490.00	114,412,773.00	15,736,440.00
Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	0.00	99,410,043.00	0.00
Pajisje pastrimi	0.00	0.00	0.00
Mjete transporti	0.00	2,730.00	7,620,000.00
Mjete dhe pajisje teknike	1,189,305.00	0.00	8,041,440.00
Pajisje zyre dhe orendi të tjera	421,185.00	15,000,000.00	75,000.00
Studime dhe kërkime	0.00	0.00	0.00

3.3 Kategoria “Blerje mallrash”

Referuar pagesave e faturave për **Energji elektrike** shohim një diferencë të madhe mes tre universiteteve. Përgjatë periudhës së monitoruar Universitetit i Tiranës ka shpenzuar 7 herë më pak se ai i Elbasanit dhe 14 herë më pak se Universiteti i Durrësit, megjithëse ka në menaxhim më shumë godina funksionale se dy universitetet e tjera. Universiteti i Durrësit jo vetëm që kryen pagesat më të larta për energjinë elektrike me një vlerë prej 14,341,150 lekë, por nëpërmjet një transaksioni me vlerë 900,000 lekë ka kryer një pagesë ndaj një përfituesi që nuk është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me përshkrimin “10111502018Universiteti 'A.Moisiu' Durrës paguar shpenzime energji janar 2018 Faturë nr 248123731 dt 31.01.2018.

Për nënkategorinë **Ujë**, konsumatori më i madh është Universiteti i Elbasanit duke kryer transaksione me vlerë shumë më të madhe se dy Universitetet e tjera, përkatësisht 5,456,404 lekë, kundrejt shumës 311,000 lekë Universiteti i Tiranës dhe 497,052 lekë Universiteti i Durrësit.

Nisur nga problematika e ngritur disa herë për mungesën e **kartonave të diplomimit**, në muajin Qershor Universiteti i Tiranës ka kryer një pagesë me vlerë 5,210,563 lekë për këtë nënkategori, ndërsa Universiteti i Durrësit ka shpenzuar 0 lekë për nënkategorinë “Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik”.

Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Blerje mallrash	10,185,117.00	38,821,739.00	31,097,778.00
Energji elektrike	1,451,083.00	14,341,150.00	7,388,343.00
Karburant dhe vaj	0.00	6,267,510.00	2,474,282.00
Ujë	311,000.00	497,052.00	5,456,404.00
Ngrohje + Pastrim	2,794,619.00	984,000.00	940,980.00
Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	0.00	6,882,739.00	1,947,271.00
Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	5,210,563.00	0.00	359,880.00
Libra dhe publikime profesionale	83,421.00	5,982,600.00	6,189,216.00
Materiale dhe shërbime operative	150,504.00	0.00	2,463,368.00
Pajisje Informatike	183,927.00	0.00	2,723,400.00
Materiale të tjera	0.00	3,866,688.00	1,154,634.00

3.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”

Universiteti i Tiranës ka shpenzuar vlerën 21,304,490 lekë, Universiteti i Durrësit 10,780,030 lekë dhe Universiteti i Elbasanit 28,001,291 lekë për nënkategorinë **“Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave”**, shërbim i cili nuk justifikon mjaftueshëm shërbimin e sigurimit për ndërtesën apo për pajisjet që ato kanë, pasi zënë një shumë të konsiderueshme që buron nga tarifat e studentëve apo nga buxheti i shtetit dhe në përshkrimin e faturave shoqërohet me fjalët “shërbim roje”. Paradoksi për të treja këto institucione të arsimit të lartë është se vlera e shpenzuar për shërbimin roje është më e lartë se vetë vlera e investimeve që mund të ruhen nga ky shërbim.

Po Universiteti i Tiranës ka shpenzuar në nënkategorinë **telefon dhe internet** 778,129 lekë, përkundrejt Universitetit të Durrësit me 267,024 lekë dhe atij të Elbasanit me vlerën më të lartë 807,426 lekë. Megjithëse këto shpenzime arrijnë vlera të konsiderueshme krahasuar me abonimet standarte për zyra dhe familje, paradoksi qëndron në faktin se në asnjë nga këto tre universitete nuk ka as salla me internet falas për studentët dhe as wireless falas në ambientet e tyre. Pra interneti aksesohet vetëm nga punonjësit e administratës së universiteteve dhe pedagogët.

Universiteti Aleksandër Xhuvani ka kryer një transfertë me vlerë 319,440 lekë kundrejt përfituesit “Alban Tirana NASCENDO AL” me përshkrim fature “1011099 Universiteti Alkesander Xhuvani **abonim karte tv** urdhër nr 304 dt 22.12.2017 ft nr 393544435” në kategorinë shërbime të printimit dhe publikimit. Së pari, studentët duhet të informohen se paratë e tyre po shkojnë për një shpenzim luksi për zyrat e drejtuesve sic është abonimi tv, së dyti kjo vlerë nuk përkon me vlerat reale të tregut të operatorëve dixhitalë dhe së treti, ky transaksion është kategorizuar në një kategori jopërfshirëse si është ajo e publikimeve.

Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Sigurimi i shërbimeve	22,593,275.00	48,384,739.00	47,132,940.00
Posta dhe shërbimi korrier	204,118.00	37,519.00	58,414.00
Telefon dhe internet	778,129.00	267,024.00	807,426.00
Pastrim dhe gjelbërim	0.00	0.00	489,600.00
Shërbime të tjera transporti	153,136.00	41,000.00	485,454.00
Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	21,304,490.00	10,780,030.00	28,001,291.00
Shërbime të tjera	76,800.00	0.00	762,359.00
Aktivitete sociale per personelin	51,000.00	693,059.00	1,783,600.00
Mirëmbajtje ndërtesash	13,602.00	19,105,511.00	3,828,014.00
Instalim dhe mirëmbajtje rrejtesh informatike	6,000.00	4,108,029.00	10,916,782.00
Mirëmbajtje të tjera	6,000.00	13,352,567.00	0.00

3.5 Kategoritë “Transferta dhe Subvencione” dhe “Të tjera”

Në kategorinë “Të Tjera” ku janë përfshirë shpenzimet për Bursa Studimi si dhe Shpenzimet Gjyqësore, vëmë re se Universiteti i Tiranës nuk ka kryer asnjë transaksion për nënkategorinë Bursa Studimi, ndërkohë që Universiteti i Durrësit ka kryer transaksione me vlerë 24,005,909 lekë dhe ai i Elbasanit transaksione me vlerë 41,982,335 lekë. (përfshirë këtu dhe kthimin e tarifës shkollore për kategoritë e përjashtuara nga pagesa).

Pavarësisht se cila mund të jetë arsyeja që UT nuk ka paguar ende asnjë bursë studimi, megjithëse viti po akademik po mbaron, duhet theksuar se është një nga të drejtat kryesore të mohuara ndaj studentëve të cilët kur vjen afati i pagesës së tarifës tregohen mëse korrektë.

Ndërsa për kategorinë shpenzime gjyqësore, Universiteti i Tiranës ka shpenzuar 45,577,368 lekë ndërsa ai i Durrësit vlerën 7,887,113 lekë. Universiteti i Elbasanit nuk ka asnjë transaksion të kryer në këtë nënkategori. Shpenzimet në këtë kategori lidhen kryesisht me vendimet gjyqësore për largimet e padrejta nga puna. Ky është rasti kur keq-administrimi dhe papërgjegjshmëria e titullarëve rëndon mbi xhepat e studentëve pasi universiteti detyrohet të paguajë para nga tarifatat e studentëve për të paguar punonjësit e larguar në mënyrë të padrejtë nga puna.

Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Transferta dhe Subvencione	2,736,813.00	130,826.00	184,691.00
Tranferta për projekte	1,470,170.00	130,822.00	153,120.00
Kuota Anëtarësimi	1,266,643.00	0.00	17,771.00
Komisione Bankare	0.00	4.00	13,800.00
Të tjera	45,577,368.00	31,893,022.00	41,982,335.00
Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	0.00	24,005,909.00	41,982,335.00
Shpenzime gjyqësore	45,577,368.00	7,887,113.00	0.00

4. Autonomia financiare e universiteteve publike

Reforma e ndërmarrë nga qeveria në vitin 2015 synonte kryesisht t'u krijonte universiteteve publike një autonomi veëqeverisëse me të ardhura që mund ti gjeneronin nga tarifat e studentëve dhe burimet e tjera të financimit. Në nenin 3 të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë thuhet shprehimisht se “Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, **autonomi financiare**, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”²

Qëndresa Qytetare, pasi evidentoi faktet e keqmenaxhimit dhe tjetërsimit të fondeve për arsimin dhe shkencën nga ana e universiteteve, për të zbuluar se kush firmos dhe kush vendos për menaxhimin e fondeve përfshiu në monitorimin e saj aktivitetin e Bordeve të Administrimit, si organe të cilave ligji u njeh të drejtën e mbarëvajtjes financiare dhe administrative të universitetit nga administrimi i të ardhurave e deri në emërimin dhe shkarkimin e administratorit të IAL-ve. Në shqyrtim u morën Bordet e Administrimit të tre universiteteve të përfshira. Referuar përbërjes së tyre, bordi i Universitetit të Tiranës nga 7 anëtarë, 4 prej tyre janë nga universiteti dhe rrjedhimisht janë ata që vendosin për të ardhurat dhe shpenzimet e kryera.

Në Bordin e Administrimit të dy universiteteve të tjera, të Durrësit dhe Elbasanit, shumicën në bord e zotëron Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të cilës ligji i njeh të drejtën për të emëruar 4 anëtarë nga 7 në total, kur mbi 50 % e buxhetit afatmesëm të universitetit sigurohet nga fondet e buxhetit të shtetit për arsimin. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore, sipas ligjit duhet të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, ekonomike dhe juridike.

Nga monitorimi ynë dhe pasqyra e transaksioneve financiare rezulton se UT, ku shumicën e ka vetë universiteti, nuk ka arritur të shpenzojë dot paratë për shkak të ngërçeve dhe mosmarrëveshjeve midis vetë anëtarëve të Bordit dhe Senatit, problematikë e cila është bërë publike nga vetë rektori dhe ka bllokuar një sërë procesesh akademike, duke filluar nga pagat, kartonat e diplomave, sistemin informativ e me radhë.

Ndërsa dy universitetet, shumicën e bordeve të të cilave e zotëron MASR, sipas pasqyrës dhe monitorimit tonë, paratë janë shpenzuar, por jo në funksion të kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve. Tendencë që vihet re nga transaksionet e zbuluara na tregon qartazi mungesën e vizionit dhe

² https://arsimi.gov.al/files/userfiles/akteligjore/Aktet_nenligjore.pdf

përgjegjshmërisë së personave të emëruar në këto borde të cilët në shumicën e rasteve janë punonjës dhe burokratë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të cilët thjesht i shtojnë pagës së tyre një rrogë plus duke mos bërë asnjë punë. Shpenzimet e dy universiteteve në fjalë kanë shkuar për kolltuqe, makina dhe klientë të kompanive të sigurimit.

Këto pasoja që rëndojnë mbi cilësinë e universiteteve tregojnë një mungesë të zbatimit të ligjit të arsimit të lartë në frymë nga MASR duke mos emëruar ekspertë të fushës por vartës dhe këshilltarë të vetë ministres. Nga kjo situatë e krijuar lindin dy pyetje, a janë këto universitete autonome nga ana financiare? A ka rezultuar e shëndetshme për universitetet dhe studentët kjo autonomi e krijuar apo sajuar në të dyja rastet e analizuara?

Analizë e veprimtarisë së Bordit të Administrimit të Universitetit "Aleksandër Xhuvani"

REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. ~~882~~ Prot. Elbasan, më 10/07/2017

VENDIM
Nr. 13 datë 10/07/2017

"PËR VENDOSJEN E PAGESËS SË SHPËRBLIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni. 48 - neni 50, Bordi i Administrimit në mbledhjen e Tij të datës 10.07.2017,

VENDOSI:

- Të caktojë masën e shpërblimit mujor për Bordin e Administrimit të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" si më poshtë:
 - Kryetari i Bordit të shpërblehet në masën 40,000 lekë
 - Antarët e Bordit të shpërblehen në masën 35,000 lekë
- Efektet financiare të pagesës fillojnë nga 01.02.2017 dhe përballohen nga fondet e përcaktuara për shpërblimin e organeve drejtuese në Buxhetin e vitit 2017.
- Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.




Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për ta ilustruar më tej Qëndresa Qytetare ka sjellë rastin e Bordit të Administrimit të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" duke bërë transparencën e përbërjes, vendimeve dhe veprimtarisë së bordit të këtij universiteti.³ Bordi i Administrimit të Universitetit të Elbasanit është mbledhur vetëm 7 herë gjatë vitit 2018 dhe disa herë më shumë gjatë vitit 2017. Anëtarët e këtij bordi nëpërmjet vendimit nr.13, datë 10/07/2017 i kanë caktuar vetes një shpërblim mujor prej 35.000 lekë në muaj, që tregon faktin e sipërpërmendur se pagave të tyre prej burokrati i

është shtuar edhe një shumë e konsiderueshme mujore.⁴

³ <http://www.uniel.edu.al/index.php/al/bordi-administrimit>

⁴ http://www.uniel.edu.al/vendime/Vendimi_Bordi_Administrimit_Korrik_2017.pdf

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 14 Prot. / 14
 Elbasan, më 01/06/2018

VENDIM
 Nr. 71 datë 01/06/2018
 "Për..."

vendosjen e tarifave të tjera në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, Bordi i Administrimit në mbledhjen e Tij të datës 01/06/2018,

VENDOSI:



1. Tarifat për shërbimet e ndryshme që kryhen në Universitet të jenë:

Tarifat e shërbimit të ndryshme			
Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Çmimi
1	Vërtetime diplomimi (para marrjes diplomës)	lekë	500
2	Certifikatë notash (dublikatë)	lekë	1,000
3	Programe mësimore	lekë/ program	200
4	Librezë studentit	lekë	500
5	Diplomë me suportin e saj	lekë	3,500
6	Verifikim diplome	lekë	2,000
7	Pjesëmarrje në Konferencë Shkencore	lekë	5,000

Një akt tjetër i Bordit të Administrimit, i cili prodhon debat dhe rëndon mbi xhepat e studentëve është vendimi nr. 11 i datës 01/06/2018. Në këtë vendim përcaktohen disa nga tarifatat e universitetit për studentët të cilët pavarësisht se paguajnë tarifatat e studimit më të larta në Europë u duhet të paguajnë para shtesë edhe për vërtetime notash e libreza që universiteti referuar praktikave të vendeve fqinje dhe të BE duhet ti ketë dixhitale dhe falas për studentët.⁵

5. Transparenca e Institucioneve të Arsimit të Lartë

Qëndresa Qytetare monitoroi dhe testoi zbatimin e të drejtës së informimit nga ana e tre universiteteve publike të përzgjedhura duke dërguar brenda vitit akademik 2017 – 2018 plot 30 kërkesa për informacion dhe duke vëzhguar programet e tyre të transparencës.

FATURË PËR ARKËTIM

NR. _____ Datë _____

BANKËS CREDINS

Me anë të kësaj fature kërkohet që Banka juaj të pranojë nga Klienti/Persona /Persona Fizikë/Persona Juridikë arkëtime të të ardhurave për llogari të institucionit tonë me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit **UNIVERSITETI I TIRANËS REKTORATI**
 Kodi i Institucionit **1011039**
 Kodi i Degës së Thesarit ku vepron **3535**
 Emri i Paguesit _____
 Numri i Identifikimit të Paguesit _____

ID e DETYRIMET	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që Arkëtohet
	Emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	
	Tarifë për të drejtë informimi	7111099	1000 Lekë
	TOTALI		

Institucioni **Universiteti i Tiranës** Klienti _____
 (Emër Mbiemër) _____
 Adresa _____
 Kontakti _____

Nga 30 kërkesat e dërguara, vetëm për dy prej tyre morëm përgjigje në afat nga Universiteti i Tiranës por ky universitet para se të përgjigjej dërgoi një faturë në vlerën 1000 lekë të reja për ta paguar në këmbim të këtij shërbimi, me arsyetimin se neni 13 i ligjit për të drejtën e informimit i lejon të vendosë një tarifë të tillë në këmbim të informacionit. Ekspertët e Qëndresës Qytetare e ankimuan këtë tarifë si të anti-ligjshme pranë

⁵ http://www.uniel.edu.al/vendime/Vendime_Bordi_Administrimi_Qershor_2018.pdf

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ky i fundit doli me një vendim për të urdhëruar senatin akademik të UT për të shfuqizuar tarifën.

Neni 13 i ligjit për të drejtën e informimit përcakton se kostoja e kërkuar për kërkesat për informacion nuk duhet të kalojë koston fikse të materialeve që do printohen, së dyti, kur informacioni kërkohet me e-mail kostoja e shërbimit është 0, dhe së treti, informacioni që studentët kërkuar, ligjërisht duhet të ishte i shpallur në Programin e Transparencës. Kjo tarifë vjen si rezultat i vendimit nr. 60 “për tarifën” ku vetë rektorati kishte përcaktuar shumë fikse për të dhënë informacion. Nga ana tjetër të treja universitetet nuk i janë përmbajtur respektimit të ligjit për të drejtën e informimit sa i përket informacioneve që duhet të kishin publikuar në Programin e Transparencës, duke theksuar se edhe pyetjet që iu drejtuan universiteteve nga studentët kishin të bënin me kategori informacioni që sipas ligjit duhet të ishin bërë vetë publike. Universitetet nuk kanë të shpallura informacionet mbi kontratat me të tretët, kualifikimet e stafit dhe procedurat e prokurimit. Sa i përket transparencës së vendimeve të Bordeve të Administrimit, pas kërkesës për informacion të Qëndresës Qytetare, Universiteti i Elbasanit në muajin Qershor i shpalli në faqen e vet ndërsa dy universitetet e tjera nuk i kanë të shpallura. Këto vendime së bashku me kontratat përmbajnë të dhëna dhe efekte financiare për studentët, pedagogët dhe jetën akademike dhe minimalisht duhet të jenë të shpallura për të krijuar mundësinë e llogaridhënies dhe monitorimit të ekzekutimit të buxheteve.

6. Rekomandime

- **Komisioni Parlamentar i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik** duhe të marrë në shqyrtim këtë raport sa i përket aspektit të autonomisë financiare dhe efektivitetit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë për universitetet publike duke propozuar masa konkrete për zgjidhjen ligjore të ngërçeve. Gjithashtu ky Komision duhet të ngrejë problematikën e rritjes së buxhetit për arsimin nëpërmjet transfertave të kushtëzuara për universitetet, me kushtin që paratë të shkojnë për shkencë dhe shërbime ndaj studentëve dhe jo për shpenzime luksi dhe pagë shtesë për zyrtarët.
- **Kontrolli i Lartë i Shtetit** duhet të ndërhyjë menjëherë nëpërmjet auditimit profesional të universiteteve publike për të zbuluar shpenzimet abuzive, shpenzimet e pa justifikuara dhe të realizuara jashtë kategorive të parashikuara në buxhet, në raport me nevojat e studentëve.
- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë** si autoriteti mbikqyrës i financave të universiteteve duhet të monitorojë dhe instruktojë skemën e shpërndarjes së të ardhurave në investime dhe shërbime sipas një manuali apo modeli të paracaktuar për të mos i lënë vend abuzimeve me kontratat dhe prokurimet në disfavor të studentëve. Gjithashtu duhet të monitorojë të gjitha universitetet publike, jo vetëm ato universitete ku nuk ka shumicën në Bordin e Administrimit.
- **Departamenti i Antikorrupsionit në Policinë e Shtetit** në bashkëpunim me prokurorinë dhe KLSH të nisë hetimet e nevojshme për ato veprime financiare abuzive që përbëjnë vepra dhe kundravajtje penale.
- **Senatet Akademike dhe Këshillat Studentore** të universiteteve duhet të kërkojnë informacione të detajuara se si shpenzohen paratë, pse nuk investohet për shkencën, kush janë kontraktorët që përfitojnë paratë e tarifave të studentëve pa i kthyer në shërbime për ta dhe pse nuk publikohen vendimet e Bordeve të Administrimit.
- **Rektorët e Universiteteve dhe Bordet e Administrimit** të publikojnë vendimet dhe kontratat me palët e treta për çdo veprim financiar si dhe të informojnë senatet dhe Këshillat Studentorë në lidhje me investimet e vitit akademik nëpërmjet procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.
- **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** të detyrojë titullarët e universiteteve për të publikuar programin e transparencës në mënyrë që të jetë efektiv, i përditësuar dhe jo formal.

7. Shtojcë

Tabela e shpenzimeve sipas kategorive të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Durrësit "Aleksandër Moisiu" dhe Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për periudhën 1 shtator 2017 – 13 qershor 2018

	Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
II	Shpenzime personeli	48 607 808,00	336 293 751,00	257 745 722,00
2,1	Paga	29 798 222,00	293 151 821,00	243 818 941,00
2,2	Honorare + Te tjera shperblime per personelin	16 731 529,00	17 966 673,00	31 642,00
2,3	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	1 327 695,00	18 300 447,00	0,00
2,4	Dieta Udhetime	750 362,00	1 300 170,00	4 502 318,00
2,5	Pagesa anetaret e bordit administrativ	0,00	5 574 640,00	9 392 821,00
III	Investime	1 610 490,00	114 412 773,00	15 736 440,00
3,1	Rikonstrukcion i ndërtesave shkollore	0,00	99 410 043,00	0,00
3,2	Pajisje pastrimi	0,00	0,00	0,00
3,3	Mjete transporti	0,00	2 730,00	7 620 000,00
3,4	Mjete dhe pajisje teknike	1 189 305,00	0,00	8 041 440,00
3,5	Pajisje zyre dhe orendi të tjera	421 185,00	15 000 000,00	75 000,00
3,6	Studime dhe kërkime	0,00	0,00	0,00
IV	Blerje mallrash	10 185 117,00	38 821 739,00	31 097 778,00
4,1	Energji elektrike	1 451 083,00	14 341 150,00	7 388 343,00
4,2	Karburant dhe vaj	0,00	6 267 510,00	2 474 282,00
4,3	Ujë	311 000,00	497 052,00	5 456 404,00
4,4	Ngrohje + Pastrim	2 794 619,00	984 000,00	940 980,00
4,5	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	0,00	6 882 739,00	1 947 271,00
4,6	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	5 210 563,00	0,00	359 880,00
4,7	Libra dhe publikime profesionale	83 421,00	5 982 600,00	6 189 216,00
4,8	Materiale dhe shërbime operative	150 504,00	0,00	2 463 368,00
4,9	Pajisje Informatike	183 927,00	0,00	2 723 400,00
4,1	Materiale të tjera	0,00	3 866 688,00	1 154 634,00

V	Sigurimi i shërbimeve	22 593 275,00	48 384 739,00	47 132 940,00
5,1	Posta dhe shërbimi korrier	204 118,00	37 519,00	58 414,00
5,2	Telefon dhe internet	778 129,00	267 024,00	807 426,00
5,3	Pastrim dhe gjelbërim	0,00	0,00	489 600,00
5,4	Shërbime të tjera transporti	153 136,00	41 000,00	485 454,00
5,5	Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	21 304 490,00	10 780 030,00	28 001 291,00
5,6	Shërbime të tjera	76 800,00	0,00	762 359,00
5,7	Aktivite sociale per personelin	51 000,00	693 059,00	1 783 600,00
5,8	Mirëmbajtje ndërtesash	13 602,00	19 105 511,00	3 828 014,00
5,9	Instalim dhe mirëmbajtje rrejtsh informatike	6 000,00	4 108 029,00	10 916 782,00
5,1	Mirëmbajtje të tjera	6 000,00	13 352 567,00	0,00
VI	Transferta dhe Subvencione	2 736 813,00	130 826,00	184 691,00
6,1	Tranferta për projekte	1 470 170,00	130 822,00	153 120,00
6,2	Kuota Antaresimi	1 266 643,00	0,00	17 771,00
6,3	Komisione Bankare	0,00	4,00	13 800,00
VII	Të tjera	45 577 368,00	31 893 022,00	41 982 335,00
7,1	Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	0,00	24 005 909,00	41 982 335,00
7,2	Shpenzime gjygesore	45 577 368,00	7 887 113,00	0,00
		0,00	0,00	0,00
	Totali	131 310 871,00	569 936 850,00	393 879 906,00
		131 310 871,00	569 936 850,00	393 879 906,00